



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:152860  
Datë: 13.03.2025  
Numri i dokumentit: 06982109

**Ac.nr.6187/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore paditëses të paditësve A.K dhe A.D të dytë të punësuar në SHFMU “H..... e K.....”, në fshatin H..... V....., Komuna e R....., të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar S.M avokat nga P....., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Av. B.O nga R....., për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës - licencimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga e paditurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.650/2021 i datës 25.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.03.2025 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, , C.nr.650/2021 i datës 25.07.2023, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar , C.nr.650/2021 i datës 25.07.2023, ka vendosur si në vijim *I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve A.K dhe A.D si dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovec - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’u paguaj kompensim nga marrëdhënia e punës – licencim, si vijon:*

*- Paditësit A.K nga fshati H..... V....., Komuna e R..... , në emër të kompenzimit për licencim, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, për 27% të pagës mujore (498.11 euro) x 27% (minusuar 58.32 Euro në listën e pagave nga shuma 134.48 euro) = 76.16 Euro x 48 muaj, t’ia paguaj shumën prej 3,655.68 Euro, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me 31.06.2022, për 10% të pagës mujore 49.81 Euro x 14 muaj, t’ia paguaj shumën prej 697.34 Euro, gjithsej shumën e përgjithshme prej 4,353.02 Euro.*

*- Paditëses A.D nga fshati K..... e M....., komuna e R....., në emër të kompenzimit për licencim, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, për 35%*

*të pagës mujore (422.95 euro) x 35% (minusuar 54.45 Euro në listën e pagave nga shuma 148.03 euro) = 93.58 Euro x 48 muaj, t'ia paguaj shumën prej 4,491,84 Euro, ndërsa nga data 19.04.2021 e deri me 31.12.2021, për 10% të pagës mujore = 42.29 Euro x 14 muaj, t'ia paguaj shumën prej 592.06 Euro, gjithsej shumën e përgjithshme prej 5,083.90 Euro apo për të dy paditës gjithsej shumën prej 9,436.92 €, me kamatën ligjore 8 % në nivel vjetor e cila është duke rrjedhur që nga data 08.08.2021 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI ME BAZË.*

*III. DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësve t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 333,0 €, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ta aprovojë ankesën e të paditurës, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar C.nr.650/2021 i datës 25.07.2023 dhe duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, si dhe ta prishë në tërësi aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

***-Ankesa e të paditurës është e bazuar.***

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit A.K dhe A.D nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar me padi pranë gjykatës së shkallës së parë i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia punës me vlerë të kontestit të 9,436.92 €.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, konform nenit 150 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.650/2021 i datës 25.07.2023 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se të paditurës i është dërguar aktvendimi për përgjigje në padi, ndërsa gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë. Ndërsa e paditura, e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor. Me të cilën e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës (diferencës në pagë) për arsye se

përfaqësuesi i paditësve kërkesëpadinë e vet e ka bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e cila tani më ka skaduar. Paditësit duhet tu përshtaten procedurave ligjore ku sipas nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë(30) ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ apo e drejta që i takon. Ku citon se paditësit i referohen periudhës kohore kur nuk ka pasur vlefshmëri të KKAK.Neni 87 i ligjit të punës,citim Afati i parashkrimit të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para,parashkruhen brenda afatit prej tri(3) vitesh,nga dita e paraqitjes së kërkesës,si dhe neni 90 për Kontratën kolektive.Duke theksuar se përgjegjëse për pagesën shtesë për kualifikim duhet të i drejtohet Qeverisë së Kosovës ku Qeveria duhet të ishte e paditura,si dhe neni 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 nuk e obligon të paditurën me këtë kompensim si në kërkesëpadi. Por këtyre pretendime me përgjigje në padi të të paditurës gjykata i refuzoj si të pabazuara duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit, Nr.2056, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18 prill 2017,në nenin 7,par.1,nëpar.1.4 dhe Vendimit të Qeverisë se nuk i është paguar diferenca në pagë për mësimdhënësin me licencim, dhe kjo vërtetohet përmes vërtetimit për muajt e prezencës në punë për paditësin A.K me nr. 1550/I, të datës 18.06.2021, vërtetimi për muajt e prezencës në punë për paditësen A.D me nr. 1545/I, të datës 18.06.2021, diploma e fakultetit për paditësen A.D, me gradën Master i arteve në politikat sociale dhe mirëqenia e fëmijëve, me nr.1422/20, prej datës 23.09.2020, aktvendimi mbi licencimin e mësimdhënëses për paditësen A.D, me nr.100008482 e datës 26.12.2012, aktvendimi mbi licencimin e mësimdhënësit për paditësin A.K, me nr.1009356 prej datës 26.12.2012, diplomën e fakultetit për paditësin A.K me nr.357, të datës 01.07.2015, kontratë e punës për paditësin A.K nr. i prot.1201/I, data 01.09.2015, kontratë e punës për paditësen A.D nr. i prot.1180/I, data 01.09.2015. Gjykata e shkallës së parë për kamatë ka vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-së. Ndërsa për shpenzimet e procedurës, ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkëlqje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 160 paragrafi 3 dhe,4 të LPK-së, si dhe ka zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Neni 160 paragrafi 3 i LPK-së përcakton "*160.3 Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.*"

Kurse neni 160.4 parasheh "*Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.*"

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në mënyrën se si është formuluar është i paqartë dhe i pa ekzekutueshëm. Një paqartësi e tillë del nga fakti se gjykata e

shkallës së parë, në dispozitiv të aktgjykimit, përfshinë edhe kalkulime të pagës bazë dhe të drejtës së kërkuar, të ndara në dy periudha kohore, një përmbajtje e tillë e cila e bën të pakuptueshme se çka është aprovuar dhe çka jo.

Përveç tjerash në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, pas përshkrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, nuk jep ndonjë arsye se çka vërtetohet konkretisht përmes të njëjtave, por mjaftohet me përshkrimin e tyre dhe duke kaluar direkt në përfundimin që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, e që në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, dispozita e nenit 160 paragrafi 4 e LPK-së, përcakton detyrim ligjor, që arsyetimi i aktgjykimit të përfshijë edhe faktet të cilat janë vërtetuar përmes provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse.

Po ashtu në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në zbatim të gabuar të drejtës materiale, kjo sepse kërkesa e paditësve është e ndarë në dy periudha kohore nga data 18.04.2017 deri me 18.04.2021 për 27 % të pagës mujore, kurse prej 19.04.2021 e deri me 31.06.2022 për 10% të pagës mujore, kurse gjykata e shkallës së parë të dy kërkesat i arsyeton mbi bazën juridike të Kontratës Kolektive të Arsimit, mirëpo nuk i referohet edhe vendimit të Qeverisë në të cilën përcaktohet një e drejtë e tillë dhe gjithashtu gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të prapësimit të paditurës për parashkrimin e kërkesës, kjo sepse padia është paraqitur në vitin 2021, kurse kërkesa e paditësve përfshin periudhën kohore të vitit 2017, e që në vlerësimin e kësaj gjykate për kërkesat e vitit 2017 afati i parashkrimit ka arritur gjatë vitit 2020. Përveç të lartcekurave ka zbatim të gabuar të drejtës materiale edhe në llogaritjen e pagës së paditësve, kjo pasi që Vendimi i Qeverisë dhe KKA përcaktojnë pagën bazë dhe jo pagën bruto apo neto.

Andaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë, të marrë një aktgjykim me përmbajtje ashtu siç përcakton dispozita e nenit 160 të LPK-së, të vlerësojë lartësinë e kërkesëpadiës së paditësve mbi pagën bazë sipas listës së pagave dhe jo pagën neto apo bruto, si dhe të vlerësojë dhe njëherë prapësimin e parashkrimit të paraqitur nga e paditura, pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga se u tha më lartë, e në kuptim të nenit 194 dhe 195 pika c) në lidhje me nenin 197 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6187/2023, me datë 11.03.2025**

**Kryetar i Kolegjit - Gjyqtari**  
***Faton Ademi, d.v***